



**Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.**



**Kontrata e Përgjithshme
e Punës për sektorin
e pastrimit 2016/2017
të Zvicrës gjermanofolëse
rregullon kushtet tuaja të
punës**

Kush është Unia?

Unia me 200 000 anëtarë është sindikata më e madhe ndërprofesionale në Zvicër. Ajo nuk angazhohet vetëm për arritjen e Kontratave të Përgjithshme të Punës, e kështu edhe për paga të mira, siguri sociale dhe kushte të punës, por ofron edhe një varg shërbimesh tjera. Ne përfaqësojmë punëmarrësit dhe punëmarrëset në vendin e punës, pranë sigurimeve sociale, për shkollimin e mëtutjeshëm, në rast papunësie dhe pranë gjykatës. Unia është e vendosur në të gjitha regjionet e Zvicrës – edhe në afërsinë tuaj – dhe posedon një strukturë të gjerë, një rrjet të mirë lidhjesh, dhe është një partnere kompetente.

Unia Zentralsekretariat

Weltpoststrasse 20
Postfach 272
CH-3000 Bern 15
T +41 31 350 21 11
info@unia.ch
www.unia.ch

Unia në afërsinë tënde:



Dhuratat për përvjetorë

Të gjitha punëtoret dhe punëtorët pas 10 vitesh përvjetorë pune në një ndërmarrje dhe pastaj pas çdo pesë vitesh duhet të marrin si dhuratë të përvjetorit një dhuratë në korniza të një çerek (1/4) page mujore.

Fondi për zbatim

Me këtë KPP në një rënë anë do të përkrahesh shkollimi i mëtejshëm i punëtoreve dhe punëtorëve në sektorin e pastrimit dhe në anën tjetër, përmes kontrollit të rreptë do të sigurohet zbatimi i dispozitave të KPP-së nga të gjitha ndërmarrjet. Mirëpo kjo kushton. Për këtë qëllim do të zbritet nga paga një kuotë e zbatimit. Shuma e kësaj kuote për punonjësit dhe punëdhënësit ndahet kështu: 0,4 për qind zbritet nga paga bruto e punëtorëve dhe 0,2 për qind paguan punëdhënësi nga shumata e pagave. Shërgertët (nxënësit) paguajnë 1 frang në muaj. Anëtarëve të sindikatës u kthehet pjesa e kuotës së tyre të paguar nga sindikata.



pagës për tri javë, e me rritjen e stazhit të punës edhe më gjatë. (Kohëzgjatja e saktë ndryshon varësisht prej kantonit. Ju lutemi të informoheni pranë sindikatës tuaj).

Koha e udhëtimit

Koha e udhëtimit nga vendi i zakonshëm i punës deri te klienti llogaritet si orar i paguar i punës (kohë e punës si dhe shpenzimet e udhëtimit). Koha e udhëtimit nga vendbanimi deri tek vendi i zakonshëm i punës nuk paguhet. Për punimet në terren duhet të paguhen shpenzimet dhe koha e udhëtimit prej vendit të tubimit, ose nëse mungon ky vend, atëherë prej selisë së ndërmarrjes deri në vendin e punës.

Dreka

Nëse orari ditor i punës zgjat së paku 6 orë dhe dreka duhet të merret patjetër jashtë vendit të zakonshëm të punës, atëherë duhet të paguhet një kompensim i drekës me një shumë prej së paku 16 franga në ditë.

Rrobat e punës

Rrobat e punës duhet të vihen në dispozicion nga punëdhënësi. Pastrimi dhe harrimi i rrobave është çështje e punëtores apo punëtorit.



Mungesat e shkurtra të paguara

- Vdekja e bashkëshortit, babait, nënës, fëmijës 3 ditë
- Në rast vdekjeje të vëllezërve apo motrave si dhe vjehrrit/ës 1 ditë
- Në rast martesë të punëtorit/es 3 ditë
- Në rast lindjeje të fëmijës 1 ditë
- Në rast inspektimi ushtarak: 1 ditë
- Në rast ndërrimi të banesës (maksimalisht 1 herë në vit) 1 ditë
- Bartësit e funksioneve të zgjedhur të sindikatave 1 ditë


Vazhdimësia e pagesës së pagës gjatë sëmundjes

Të gjitha punëtoret dhe punëtorët me një shkallë të punësimit prej së paku 12,5 orë në javë janë të siguruar kundër humbjes së pagës në rast sëmundjeje. Paga e mëditjes gjatë sëmundjes, duke filluar nga dita e tretë është 80% e pagës së fundit (apo mesatarja e gjashtë muajve të fundit) dhe paguhet më së shumti 730 ditë. Dy ditët e para të sëmundjes nuk paguhen (kohë e pritjes). Kush punon më pak se 12.5 orë në javë, në rast sëmundjeje gjatë vitit të parë të punësimit, ka të drejtë vazhdimësie të



Die Gewerkschaft.

- Unia angazhohet për kushte më të mira të punës dhe siguron përparimet tjera të rëndësishme sociale.
- Në shumicën e seksioneve gleni sekretar/e kompetent/e, të cilët/at ju këshillojnë dhe iu përgjigjen pyetjeve tuaja mbi të drejtat e punës, sigurimet sociale dhe të drejtat e të huajve, në gjuhën tuaj amtare.



Geschäftsantwortsendung Invio commerciale-risposta
Envoi commercial-réponse

Nicht frankieren
Ne pas affranchir
Non affrancare

Unia Zentralsekretariat

Weltpoststrasse 20
Postfach 272
CH-3000 Bern 15

Së bashku jemi më të fortë!

Koha e punës së bërë duhet të regjistrohet gjithmonë!

Shumë punëmarrës në degën e pastrimit ankohen se koha e tyre e punës nuk llogaritet si duhet dhe se atyre nuk u paguhen të gjitha orët e bëra të punës.

Prandaj, në Kontratën e re ne kemi futur një nen nga Ligji i Punës. Aty është shprehimisht e shkruar se, koha e punës së bërë duhet të regjistrohet dhe llogaritet për çdo ditë. Kjo mund të bëhet në mënyrë elektronike apo me dorë në një fletëregjistrim. Këtu duhet të shënohet qartë:

- Në cilin objekt është bërë puna
- Kur ka filluar dhe kur ka përfunduar puna (p.sh. Fillimi në orën 7.35, përfundimi në orën 12.45)
- Kur janë bërë pauza të papaguara (p.sh. 9.45 – 10.00 paузë)

Si rregull, punëmarrësi/ja duhet ta nënshkruajë këtë tabelë për çdo javë. Nënshkruani vetëm kur koha e regjistruar e punës së bërë të jetë në rregull.

Nëse koha e punës së bërë është regjistruar keq, atëherë regjistroni kohën tuaj të punës ditore në kalendarin tuaj dhe drejtohuni tek Unia.



Vlefshmëria dhe nivelet e kualifikimeve në KPP të re

Vlefshmëria

KPP vlen për të gjithë ata që kryejnë punë pastrimi prej punëtorit/es e deri tek kryepunëtori/ja si dhe drejtuesi/ja i/e objektit dhe për të gjitha ndërmarrjet që punësojnë më shumë se pesë bashkëpunëtorë. Për ndërmarrjet me më pak se pesë të punësuar vlejnë po ashtu kushtet e pagës prej vitit 2012. Kjo KPP vlen edhe për punëtorët me orar të reduktuar. Përjashtim bëjnë të rinjtë të cilët punojnë si ndihmës gjatë pushimeve.

Nivelet e kualifikimit

Pastrues/e mirëmbajtjeje I: Punëtor/e me detyra pastrimi në mirëmbajtje (punë e rregullt në pastrim, psh. pastrimi i zyreve) deri në 3 vite të plota pune.

Pastrues/e mirëmbajtjeje II: Punëtor/e me detyra pastrimi në mirëmbajtje që nga viti i 4 i punës.

Pastrues/e mirëmbajtjeje III: Punëtor/e me detyra pastrimi në mirëmbajtje që nga viti i 7 i punës.

Pastrues/e special/e I: Punëtor/e pa përgatitje profesionale por që kryejnë punë pastrimi që kërkojnë njohuri speciale pastrimi (Psh. pastrim ndërtesash, pastrim largimi nga banesat, pastrim fasadash) deri në mbarim të vitit të 4 të punës.

Pastrues/e special/e II: Punëtor/e me përgatitje profesionale apo me mbi katër vite përvojë pune ose me dëftesë konfederale mbi aftësimin profesional, që kryejnë punë në pastrimin special.

Pastrues/e special/e III: Punëtore/ë me dëftesë konfederale mbi aftësimin profesional apo dy vite pranimit të dëftesës konfederale mbi aftësimin profesional me detyra pastrimi në pastrimin special.

Pastrues/e i/e spitalit I: Punëtore/ë me detyra pastrimi në spital deri/dhe me 3 vite të plota të punës.

Pastrues/e i/e spitalit II: Punëtore/ë me detyra pastrimi në spital që nga viti i 4 i punës.

Pastrues/e i/e spitalit III: Punëtore/ë me detyra pastrimi në spital që nga viti i 7 i punës.

Kontrata e Përgjithshme e Punës 2016/2017

Mindestlöhne pro Stunde

Kategoria	2016	2017
Pastrues/e mirëmbajtjeje I	18.50	18.80
Pastrues/e mirëmbajtjeje II	18.70	18.90
Pastrues/e mirëmbajtjeje III	19.00	19.20
Pastrues/e special/e I	20.40	20.90
Pastrues/e special/e II	23.05	23.30
Pastrues/e special/e III	26.50	26.80
Pastrues/e spitali I	19.25	19.50
Pastrues/e spitali II	19.65	19.90
Pastrues/e spitali III	20.05	20.30

Ruajtja e nivelit të pagës

Në rast të ndërrimit të punëdhënësit bashkëpunëtori/bashkëpunëtorja ka të drejtë të ruajë nivelin e njëjtë të pagës, të cilën e ka marrë te punëdhënësi i mëparshëm.

Paga e trembëdhjetë

Të gjithë të punësuarit/at në pastrim kanë të drejtë në pagën e 13-të.

Orari i punës

Orari normal javor i punës zgjat më së shumti 42 orë. Orët e tepërta të punës duhet të kompensohen më së



vone deri më 31 mars të vitit pasues. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ato duhet të paguhen me një shtesë prej 25%.

Pushimi

- Pesë javë apo 25 ditë pune deri në moshën 20 vjeçare
- Katër javë apo 20 ditë pune duke filluar nga moshë 21 vjeçare
- Pesë javë apo 25 ditë pune nga moshë 50 vjeçare dhe pas së paku 5 vite përvojë pune.

Ditët festive

Ditë të lira feste me pagesë janë 1 gushti si dhe tetë ditë të festave kantonale.

Pushimi i lehonisë

Pas lindjes, pushimi i amësisë (lehonisë) është 16 javë dhe me kompensim prej 80 për qind të pagës së fundit të paguar (apo mesatarja e gjashtë muajve të fundit). Kush nuk i përmbush kushtet ligjore për kompensim të pagës gjatë pushimit të paslindjes, për shkak të kohëzgjatjes së punës dhe pagesës së kuotave në AHV/AVS, falë KPP do të merr kompensim të pagës në lartësi prej 80 për qind gjatë 8 javëve.

Edhe ju keni nevojë për një partner të fuqishëm në jetën profesionale – anëtarësohuni në sindikatën Unia!

- Më dërgoni një KPP të sektorit të pastrimit për Zvicrën gjermanofolëse
- Unë kam edhe pyetje tjera. Më kontaktoni
- Dëshiroj të anëtarësohem në Unia
- Më dërgoni dokumente shtesë mbi Unia

Mbiemri

Emri

Adresa

PLZ/Vendi

Tel.

E-Mail